

**ULLMAR KVIK DHE LIBRI I TIJ  
“MË SHUMË HEROIZMA, SE SA GRURË”**

*“Unë, nëse do të jetoja edhe një herë, do të punoja me shqiptarët dhe për shqiptarët...”*

*Ullmar Kvik (Qvick)*

**Kush është Ullmar Kvik ?**

Ullmar Kvik lindi më 13 qershor 1934, në Suedi. Babai i tij ishte punëtor, por me interesa intelektuale për artet, politikën dhe natyrën. Nëna ishte shtylla e familjes. Me sakrificat e familjes, Ullmari i ri i vazhdoi studimet në gjimnaz dhe në shkollën pedagogjike. Ai u interesua për çështjet ndërkombëtare, për gjuhë të huaja, dhe ky interesim u forcua përmes dëgjimit të radiostacioneve të botës. Në këtë mënyrë ai mori kontakt me Radio Tiranën, Radio Shkodrën dhe Radio Kukësin. Në vitin 1969, fillon intensivisht të mësojë gjuhën shqipe, përmes literaturës që i vinte nga Shqipëria. Ndërkaq, në vitet '70, '78, '79, '94, e vizitoi Shqipërinë, kurse në vitin '95 mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar “Shkodra ndër shekuj”. Në vitet 1970 dhe 2004, merr pjesë në seminarin për albanologët e huaj që organizohet në Prishtinë. Gjatë viteve '70, Ullmari ka pasur kontakte të dendura me arbëreshët e Italisë. Ndërkaq, në vitin 1994, e ka vizituar edhe Maqedoninë Perëndimore. Më se një gjysmë shekulli kontakte me botën shqiptare nga Suedia!

Në Suedi, Ullmari ka qenë zëdhënës jozyrtar i Shqipërisë dhe i mbarë kombit shqiptar. Ishte bashkëpunëtor e më vonë edhe kryetar i Shoqatës Suedeze-Shqiptare, që u themelua në vitin 1970, e ku për 10 vjet u botua “Buletini”, një tribunë për shqiptarët në Suedi dhe për letërsinë shqipe. Që nga viti 1981 bashkëpunon me gazetën e re “Albanien och vi” (“Shqipëria dhe ne”). Në vitin 2002,

Shoqata Suedeze- Shqiptare u shndërrua në Komitetin Shqiptaro-Suedeze, ku Ullmari pareshtur dha kontributin e tij. Pothuajse të gjitha përkthimet letrare nga shqipja në suedisht kanë kaluar nëpër duart e Ullmar Kvikut. Ka botuar në suedisht një seri veprash të autorëve shqiptarë, të cilat i ka përkthyer me përkushtim. Ka bashkëpunuar në përpilimin e disa veprave të tjera gjuhësore: tre fjalorë suedisht-shqip dhe një gramatikë të suedishtes, në shqip. Në vitin 2004, nga revista "Drita", në Treleborg, iu botua libri i tij dokumentar, në gjuhën suedeze, *Mera hjältemod än vete (Më shumë heroizma se sa grurë)*, ku flitet për shqiptarët gjatë shekullit XX, e të cilin tashmë lexuesi e ka në dorë, përkthyer në shqip nga shkrimtari dhe veprimtari i mirënjohur Hajdin Abazi. Ullmar Kvik, në bashkëpunim me mikun e tij, Lars-Erik Morinin, kanë përgatitur fjalorin shqip-suedisht, të parin fjalor të këtij lloji. Ai ndihet krenar për emërtimin "Shqiptar Nderi", dhe për dekoratat e marra nga Zyra e Kosovës në Suedi, si dhe nga shoqata bamirëse "Nënë Tereza", dega në Suedi. Ullmari është anëtar shumëvjeçar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Suedisë.

### 1.

Ka kohë që më ka ngacmuar dëshira për t'u shprehur për personalitetin e letrave suedeze dhe shqipe Ullmar Kvik, mikun e madh të shqiptarëve, këtë njeri të rrallë e të përkushtuar gjer në madhësi për kombin shqiptar. Por, nuk është vetëm kjo arsyeja e këtij shkrimi. Edhe sikur vetëm kaq, mjafton për të shkruar faqe të tëra, po kësaj here, sapo mbarova së lexuari librin e tij të njohur, "*Më shumë heroizma sesa grurë*", ku Ullmar Kvik, arrin të realizojë me përkushtim dhe kompetencë një analizë dokumentare të historisë dhe jetës shoqërore të shqiptarëve të shekullit XX, e cila është po aq, edhe një vepër me vlera publicistike, artistike e gjuhësore. Respektoj dhe mbështes plotësisht mendimin e përkthyesit të këtij libri, Hajdin Abazi, i cili, në parathënie, shkruan: "Ullmar Kvik, me qetësinë tipike suedeze dhe me vendosmëri të palëkundshme, për një gjysmë shekulli ka qenë i lidhur shpirtërisht me popullin shqiptar. Me punën dhe angazhimin e tij që ka bërë për kulturën dhe letërsinë, për poezinë dhe afirmimin e shqiptarëve si një komb evropian, me zërin që ka ngritur kundër shtypjes së shqiptarëve nga shovinizmi serb - Ullmar Kvik është figura suedeze më

markante që na bën të ushqejmë respekt të përhershëm ndaj tij, ndaj përkushtimit të tij për gjithë atë që është shqiptare, veçmas për përkrahjen me gjithë zemër që u ka bërë prirjeve tona për të flakur të kaluarën e errët dhe për t'u rilidhur me kombet e kontinentit, pra me Perëndimin".

Që në hyrje të librit, Ullmar, argumenton bindshëm origjinën e lashtë ilire të shqiptarëve dhe zhvillimin si komb, duke nënvizuar faktin se ndaj Shqipërisë ka pasur në shekuj invazione të shumta pushtuese, që përpos dhunës dhe shkatërrimit, bënë ç'është e mundur të tjetërsonin origjinën dhe veçoritë karakteristike të këtij populli të lashtë. Ullmar veçon se "Në luftën kundër këtij ekspansioni, shqiptarët, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, të njohur më tepër si Skënderbe, kanë luajtur një rol vendimtar". Duke përshkruar sundimin osman, autori, vijon: "Nën perandorinë osmane do të mbeten për më tepër se 450 vite dhe vetëm më 1912-n e arritën pavarësinë e tyre – por që përfshiu vetëm gjysmën e kombit. Shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e në treva të tjera mbetën jashtë kufijve". Me këtë konkluzion të Prof. Ullmar pajtohesh plotësisht, kur sjell ndërmend se nga evropianët dhe bota, shqiptarët janë lënë jo rrallë në mëshirën e fatit, të braktisur në rrugët e historisë, ndonëse pozicioni gjeografik i Shqipërisë ka qenë dhe është i bekuar nga Zoti, ndonëse ky popull, ka treguar përherë vitalitet të rrallë, duke nxjerrë pareshtur nga gjiri i tij mendje të ndritura dhe personalitete që i kanë shërbyer atdheut, Evropës dhe botës, duke dëshmuar kësisoj se "Është popull i madh, ai popull që nxjerrë njerëz të mëdhenj". E, gjithkush bindet për këtë, kur shikon se populli shqiptar ka nxjerrë një mbret si Bardhyli dhe një mbretëreshë si Teuta; një Glaukia, që, është nga të vetmit që me ushtrinë e tij, në një betejë arriti të mundte edhe Aleksandrin e Madh, mbase, kjo ngjarje, e ngjashme në një farë mënyre, me betejat triumfale të Karlit XII të Suedisë, i cili, siç thotë Ernest H. Gombrich, - "...me ushtrinë e tij luftoi Pjetrin e Madh, duke mundur një fuqi pesë herë më të madhe..."

Trualli shqiptar ka nxjerrë personalitete dhe ushtarakë të mëdhenj, të vlerësuar nga historianë të lashtë dhe të kohëve moderne. Për ilirët, paraardhës të shqiptarëve, kanë shkruar e janë shprehur shkrimtarë dhe historianë të shquar të antikitetit, si: Homeri, Herodoti, Plutarku, Apiani, Aristoteli, Straboni,

Tit Livi, Ciceroni, Cezari, Virgjili..., më pas: Shekspiri, Hygoi, Dumasi, Gotje, Bajroni, Longfellohu... Lukiani. Përmendet me nderim gjenerali i pakrahasueshëm Pirro i Epirit, teksa në vazhdim, e gjithë bota njih veprën në mbrojtje të atdheut dhe krishtërimin, të heroit më të madh të kombit shqiptar, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Historianët, radhitin ndër njerëzit e shquar të Shqipërisë, themeluesin e shtetit të pavarur të Egjiptit, Mehmet Aliun, prej të cilit zë fill dinastia mbretërore egjiptiane; Ali Pashë Tepelenën, pashain e Janinës, që luftoi për t'u shkëputur nga Turqia. Sarajet e tij, i vizituan mjaft nga personalitetet më të njohura të botës. Sabri Godo, shkruan se Aliun e vizitoi edhe Gustav Adolfi i Suedisë... Historianët përmendin bashkëpunëtorin më të ngushtë të Garibaldit, arbëreshin Francesko Krispi, i cili u bë i pari kryeministër i Italisë së bashkuar; nderojnë themeluesin e gjuhës së sotme letrare turke Sami Frashërin. Dhe, duke vazhduar, ndalemi në kohët e sotme, te Ferid Murati, përfaqësues i diasporës shqiptare në SHBA, fitues i çmimit "Nobel" në mjekësi... Janë me dhjetëra e dhjetëra njerëz të tjerë të mëdhenj, që ka nxjerrë populli shqiptar ndër shekuj, por në piedestalin më të lartë të nderit, shqiptarët kanë vendosur margaritarin më vezullues, që njih dhe përkulet me nderim e mirënjohje e gjithë bota, nobelisten Nënë Terezën e madhërishtme, e cila që në vështrimin e saj të parë, duket se thotë: "Paqja, fillon me një buzëqeshje". Personalitete të tjera historikë të Shqipërisë, me madhështinë dhe sakrificat e tyre sublime, i kanë dhënë shumë edhe popujve fqinj. "Pa pjesëtarët e popullatës shqiptare në Greqi, - nënvizon Ullmar, - grekët nuk do ta fitonin kurrë luftën e lirisë kundër turqve: Thuajse të gjithë prijësit e shquar të palikarëve ishin shqiptarë...".

Duke përfshirë në librin e tij harkun kohor 1912 - 2001, Ullmar Kvik, parashtron dhe pasuron me argumente tezat për shqiptarët në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në diasporë, kudo ku ata jetojnë. Dihet botërisht, se kur mbërritën serbët në Ballkan, në fund të viteve 500 dhe në fillimin e viteve 600, dardanët, fis i lashtë ilir, ndodheshin në Dardanië e tyre...Teza mbi etnitetin ilir të dardanëve, mbështetet nga shumë studiues me emër, e veçanërisht nga linguistët Tomashek, P. Kreçmer, H. Krahe, N. Jokl etj. Edith Durham, shprehet: "...Dardanië, e gjejmë në hartat e Ptolomeut...".

Në aspektin onomastik, Eqrem Çabej, formimin e dardanëve, e sheh para shekullit XII para erës sonë. Historiana ruse Ana Smirnova, në veprën e saj *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, nënvizon se “Kosova u përfshi për herë të parë në përbërje të Serbisë pikërisht në periudhën e përpunimit të statusit të shtetit të ri dhe të përcaktimit të kufijve të tij, pas luftimeve ballkanike të viteve 1912 -1913. Përpara kësaj, në rrjedhë të pesëqindvjeçarit të pushtimit turk, Kosova ishte një njësi administrative më vete në perandorinë osmane”. “Serbët, - shkruan Ulmar, - prireshin nga ëndrra për Serbi të Madhe... Ata kishin luftuar për lirinë e tyre kundër turqve, e ndërkohë nuk dëshironin që shqiptarët dhe popujt e tjerë të Ballkanit të fitonin pavarësitë e tyre. Kjo provonte se mentaliteti i tyre ende ishte i ulët...”.

Ka origjinalitet mënyra e shkrimit të librit, ku kemi një ndërthurje mes artistikes dhe publicistikës, veçanërisht kur Ullmar i referohet studentit Anders, nëpërmjet të cilit, arrin të konkludojë dhe të analizojë ide, meditime, përfytyrime, mesazhe dhe pamje interesante. *Ai mendon:* “Mirë, malazezët dhe turqit mund edhe të grinden, por fuqitë civilizuese kurrë më nuk do të hidheshin kundër njëra-tjetrës - kjo ishte melodia e asaj kohe”. Në vazhdim të idesë, dihet, se, nga konfliktet e vogla, shpesh herë kanë lindur divergjencja të mëdha, ose e thënë ndryshe me gjuhën e popullit: “Një shkëndijë, ndez një mal”. Dhe në të vërtetë, “shkëndija” ose preteksti i fillimit të Luftës së Parë Botërore, ishte vrasja e kryedukës Franc Ferdinand, (trashëgimtari i fronit të perandorisë austro - hungareze), në Sarajevë të Bosnjës, nga serbo - boshnjaku Gavril Princip, më 28 qershor 1914. Ndërkohë, qëdihet gjithashtu, se pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, bota u trondit nga tmërri, kur bilanci tragjik i luftës rezultoi me afro 20 milionë njerëz të vvarë. Atëherë, ishin të shumtë ata politikanë, burra shtetesh, shkrimtarë, shkencëtarë, artistë, që bënë apel, duke gjykuar gjëmën që ndodhi. Ata kërkonin të ndalnin doemos fenomene të tilla antinjerëzore, të shkaktuara nga vetë njerëzit kundër njerëzve, shtetet kundër shteteve. Por, sapo kaluan 20 vjet nga ajo mynxyrë, bota u përfshi përsëri në vorbullën e një tragjedie disa herë më të madhe dhe më të zeze nga e para, në Luftën e Dytë Botërore, ku humbën jetën mbi 60 milionë njerëz, pa llogaritur shkatërrimet dhe dëmet materiale...

## 2.

Në librin e tij, *Më shumë heroizma sesa grurë*, autori ndalet në vlerësimin realist të Lord Bajronit, vlerësim ky artistikisht mjaft i njohur jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga bota, nëpërmjet vargjeve të mrekullueshme që Lord Bajroni, ka shkruar në poemën e tij të famshme “Çajld Harold”. Ullmar, të vë në mendime kur analizon me dhimbje zakonin e egër e tradicional të gjakmarrjes, që merrte jetë njerëzish të pafajshëm, thjesht për një kanun e zakon, për një fjalë apo mendim të thënë ndonjëherë edhe pa të keq, ashtu shkarazi. “Mirëpo si individë, - shkruan Ullmar, - sipas autorëve, ata janë të ndershëm dhe modestë, dhe mbi të gjitha sidomos mikpritës. Mikpritja e tyre jeton edhe në ditët tona më fuqishëm se në asnjë vend tjetër. Gjakmarrja është një doke tjetër karakteristike e shqiptarëve, si te malazezët dhe korsikanët; mirëpo te shqiptarët gjakmarrja kishte një kufizim të hekurt: po qe se armiku kërkon mbrojtje në emër të mikpritjes, ai mundet në mënyrë krejt të sigurtë të flejë në shtëpinë e armikut. Ligjet e mikpritjes qëndronin faktikisht mbi ato të gjakmarrjes, dhe ai që i shkel ato konsiderohet si kriminel dhe mund të vritej nga kushdo”.

Toleranca është bukuri e shpirtit njerëzor. Teksa shprehem kështu, sjell në kujtesë mendimet e një nxënësi të shkollës “Lidhja e Prizrenit” në Tiranë, në vitin 2006, në një hartim për gjakmarrjen “... Gjakmarrja nuk ekziston vetëm në zonat e Veriut, por atë ka raste që e gjen deri edhe brenda kryeqytetit. Pranë shtëpisë sime, - shkruante nxënësi - fëmijë, - jeton një familje e ngujuar. Ne gjithmonë luajmë larg asaj dere të heshtur, larg atyre mureve të lartë. Asnjëri nga ne nuk e ka parë ndonjëherë të hapur atë derë. Askush nuk e ka kaluar ndonjëherë pragun e asaj shtëpie, megjithëse atje jetojnë dy djem të vegjël në moshën tonë...”.

Shprehjet e fëmijëve tingëllojnë si kambana alarmi për jetën. Me shikimet e tyre të pafajshme dhe të kaltra si qielli, të ndritshme si drita e diellit, ata luten dhe u kërkojnë ndihmë të rriturve. Duhet bërë patjetër diçka për ata fëmijë që vazhdojnë ende të qëndrojnë të ngujuar, që të jenë sa më shpejt të lirë si zogjtë në fluturim, si dallëndyshet që shtegtojnë kontinenteve, si shqiponjat që e shikojnë diellin në sy...

### 3.

Me karakter hulamtues dhe shkencor, përshkruhet në libër lëvizja për pavarësi të shqiptarët: "Aleanca Ballkanike kishte vendosur të shpërbente Shqipërinë. Armatat e tyre kishin pushtuar pjesët më të mëdha të vendit - të cilat përmenden edhe me qëllimet shfarosëse të popullatës - dhe gjendja ishte tepër e pashpresë. Më 28 nëntor 1912, delegatët nga e tërë Shqipëria - për aq sa ata mund të arrinin, u bashkuan në qytetin e Vlorës, në bregdetin shqiptar të Jugut, në një Kuvend Nacional, dhe po atë ditë, e shpallën Shqipërinë shtet të lirë, sovran dhe të pavarur. Burrë shteti i vjetër Ismail Qemal beu, në ballkonin e shtëpisë së bashkisë e kishte ngritur flamurin shqiptar, që ishte qëndisur nga një vlonjate, Marigona. Ishte shqipja e heroit kombëtar Skënderbeu: një shqiponjë e dykrenare me ngjyrë të zezë në sfond të kuq".

Me një ndjenja të thellë humanizmi, Ullmar, ndalet në përshkrimin e vuajtjeve të shqiptarëve nga shovinizmi i fqinjëve, kurse në pjesën "*Luftë e ashpër dhe fund i ashpër*", përshkruan në mënyrë dokumentare dhe letrare vdekjen heroike trimërore të Isa Boletinit, që autori e cilëson si "*Luftëtarin e madh të lirisë*" që u bë pjesë e legjendës së popullit të tij heroik. *Ai shkruan:* "Isai arriti moshën 52-vjeçare, por u bë legjendë në popullin e tij. Ishte lindur në një fshat të vogël në periferi të qytetit kosovar Mitrovica dhe tërë jeta e tij do të mbushet përplot me luftra dhe përpjekje të tjera për të siguruar ardhmërinë e shqiptarëve". "Unë jam mirë, kur Shqipëria është mirë"! - citon Ulmar fjalët e atdhetarit të madh shqiptar. Ndërkaq ka një theks interesant dhe plot ndjeshmëri e dhembje njerëzore, kreu i titulluar "*Dashuria e pamundshme: Lule Marku*", ku morali dhe vlerat njerëzore preokupojnë ndër shekuj njerëzit dhe personalitetet. Si përfaqësues vizionar i së ardhmes dhe humanizmitç na shfaqet autori i këtij libri. Këtu pasqyrohet në mënytë të drejtpërdrejtë dashuria e një vajze shqiptare me emrin kuptimplotë shqiptar Lule dhe përballja e saj me të keqen e botës që e rrethonte. Në përshkrimin mjeshëtor të Ullmarit, të krijohet përfytyrimi i një ujëvare të kaltër me ujë pastër, porqë fati, stuhitë dhe egërsia e kohës, e përplas zhurmshëm e dhimbshëm, duke e copëtuar në shkëmbinjtë e mprehtë të një humnere të zezë. Me tregimin e tij mbresëlënës, suedezi Ullmar, shton një trëndafil

të bardhë në buqetën me lule të freskëta, që shndrisin nga vesa, për shqiptarkën e bukur, që e meritonte si askush tjetër emrin Lule. Përshkrimi i tij është mbresëlënës: “Ditën kur Aloisi iku nga Shkodra, për të mos u kthyer kurrë më, Lulja nuk pati mundësi t’i afrohej më. Ai ishte përshëndetur me të me fjalët: Lule, je me mua për jetë, në shpirtin tim. Sytë e Lules, të mbushur me lot, ishin si sy të një të dënuari me vdekje. Ajo kishte pasur kohën e vet të lulëzimit, tash kishte ardhur vjeshta dhe ajo do të fishkej e nuk do të mugullonte kurrë më. Pas fishkjes, lulja që po vdiste do ta priste dimrin nën tokën e ftohtë, të zezë”.

Po aq dhimbshëm, por me kolor tjetër, tregohet në libër zanafilla dhe përmbajtja e këngës së njohur shqiptare: “*Mbeçë, more shokë, mbeçë!*”, por, që edhe ajo shpreh atë realitet të zi bashkëshoqërues të shqiptarëve të pafat, jetëve të të cilëve, nuk u mbetej gjë tjetër, veçse të shndërroheshin në këngë të dhimbshme.

Ndërkaq, kësajvepre, i bashkohet natyrshëm edhe balada e njohur shqiptare e titulluar “Kënga e Rexhës”, që edhe sot jehon trojeve shqiptare, dhe në diasporë. Ajo kumbon në veshët e dëgjuesve të çdo kombi si një refren i dhimbshëm, që tregon fatin e keq dhe të pamëshirshëm që e ka ndjekur popullin tonë vital dhe me shpirt të rrallë human. Në librin e Ullmar, tërheq vëmendjen edhe këndvështrimi original dhe ndriçimi i figurës së liderit shqiptar Mit’had bej Frashëri. Nëpërmjet analizës së këtij personaliteti, depërtohet në mjegullën që rrethoi Shqipërinë në rrugën që zgjodhi pas Luftës së Dytë Botërore dhe qëndrimi joluajal që mbajtën forcat komuniste që po vinin në pushtet me elitën intelektuale social – politike. Ullmar bën këtu një analizë interesante, duke i çelur më shumë sytë lexuesit dhe duke ia bërë të qarta mjaft dukuri, ngjarje, fenomene të indoktrinuara, të paraqitura gjithnjë bardhë e zi. Autori demaskon bindshëm absurditetin e asaj kohe, lidhur me qëndrimet ndaj figurave të shquara të historisë kombëtare, që, gjithsesi, sot, në demokraci, po ngrihen dhe po vendosen në panteonin e nderuar të kombit shqiptar.

Në analizën e fakteve, duke qenë i anshëm vetëm me të vërtetën, Ullmar, i ballafaqon mendimet dhe kundërmendimet, thëniet dhe kundërthëniet, si ai mjeshtri fotograf, që përpiqet të lajë në laborator filmin fotografik në mënyrë sa më profesionale, që fotoja

të shfaqet sa më e pastër dhe sa më e qartë. Kështu vepron autori, edhe kur ndriçon e hedh dritë jo vetëm për episode e ngjarje, por edhe kur portretizon tipa e karaktere njerëzish, qofshin këta liderë politikë ose autoritete të respektuara e të nderuara nga populli. Ulmar i përmbahet thënies së Lukianit: "...rëndësi më të madhe ka që mendja e historianit t'i ngjajë një pasqyre, një pasqyre të pastër, të ndritshme dhe të lëmuar; ashtu siç i merr ajo figurat e sendeve, po ashtu duhet t'i pasqyrojë, pa paraqitur asgjë të shtrembëruar ose të ndryshuar në pikëpamje të ngjyrës e të formës...". Në vijim të kësaj ideje, suedezi Ullmar Kvik, ballafaqon dhe qartëson edhe vetëthëniet e disa prej protagonistëve si dhe evoluimin e mendimeve të tyre, siç është rasti i përmendjes së rrëfimit të N. Hoxhës për portretizimin interesant dhe së fundi me respekt të Mit'hat Frashërit. Ndërsa, pakëz më tej, ai përshkruan një krijim të Mit'hat Frashërit me temë gjakmarrjen, si të dojë të na sjellë përpara syve personalitetin me vlera nga dera e Frashërllinjve të famshëm të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

#### 4.

Duke analizuar e nxjerrë përfundime për karakterin, temperamentin dhe kulturën e shqiptarëve, Ullmar "kërkon" mbështetjen e studiueses së madhe angleze, mikeshë e së drejtës shqiptare Edith Durhamit, por edhe të Holger Pedersenit në albanologji, i cili i kushtoi shumë vite studimi gjuhës shqipe dhe parahistorisë së shqiptarëve, ndërkohë që i referohet autoriteteve të tjera të albanologjisë dhe shkencëtarëve e gjuhëtarëve të mëdhenj, si: Norbert Jokl, Franz Nopça, Maksimilian Lamerc...

Natyrisht që kreu "*Më shumë heroizma sesa grurë*", që pagëzon edhe titullin e librit brilant të Ullmar Kvik, përbën një monument të realizuar në detaj dhe transparent të përgjithësimit të natyrës dhe karakterit të shqiptarëve si popull, që suedezi i shquar, i shpreh mjaft bukur, këndshëm dhe me një gjuhë të pasurartistike: "Netët e gjata e të ashpra dimërore në malësinë e Shqipërisë veriore i mblidhnin njerëzit e shtëpisë dhe mysafirët, që vinin nga rrethi ose nga rrugë të gjata, në konakun e shtruar me shilte dhe jastëk. Njeriu mund të ulej në to ose në trapazan, lloj bankash të kapura për muri. Gratë, si rregull, nuk rrinin bashkë me burrat, kurse fëmijët dëgjonin syhapur tregimet e të vjetërve.

Rast i paharrueshëm ishte kur ndodhte që ndonjë rapsod, një lloj këngëtar shëtitës, të vinte për vizitë në shtëpi. Një rapsod i shkathët dinte me mijëra vargje, ku këndoheshin aktet heroike të trimave shqiptarë. Kështu kalonte mbrëmja në kullë – një shtëpi, e cila njëherësh ishte edhe një fortesë mbrojtëse me frëngji të vogla; e fëmijët do të shënonin mirë në kujtesë gjithë ç’ dëgjonin. Këngë pas kënge kushtuar trimërisë, dhe kështu krijohesh një klimë shpirtërore, ku virtytet tradicionale si besa, nderi, burrëria do të forcoheshin edhe më dhe do të përcilleshin nga brezi në brez. Pra, pikërisht ashtu sikurse Ismail Kadare e ka theksuar në poemën e tij *“Përse mendohen këto male”*, toka shqiptare ka dhënë më shumë heroizma se sa grurë.”.

Çdo lexuesi, këto fragmente jetësore dhe origjinale, në botën e qytetëruar, nuk mund të mos i sjellin ndërmend kohërat e lashta homerike, kur dhe vetë Homeri, që shpesh konsiderohet si një “rapsod shëtitës”, i këndonte në vargje historitë e Luftës së Trojës dheku të tjerë, në shekujt pas tij, i pasuruan dhe i latuan ato vargje, duke i dhënë formë e ngjyrim të përkryer, ashtu si lumi rrumbullakos dhe lëmon me ujin e tij të rrëmbyeshëm dhe të rrjedhshëm gurët dhe zajet e bardhë. Nuk ka “makinë” që ta bëjë atë lënim dhe atë latim që u bën gurëve dhe zajeve, lumi me rrëmbyershmërinë e tij në rrjedhat e kohëve. Sikurse, koha dhe njerëzit, latojnë e krijojnë vargje dhe këngë për jetën e popujve dhe të figurave të tyre më të dashura, duke i ngritur në piedestalet e legjendave dhe të gojëdhënave të tyre.

Ullmar, me një mënyrë studimore dhe analitike, vazhdimisht kur është fjala për referenca, ka ditur të qëmtojë dhe të zgjedhë figura historike e letrare me peshë, që kanë dhuruar bisqe të gjelbër dhe me lëng jetësor në trungun dhe rrënjët e atdheut tonë. Kështu, krahas Kadaresë, ai nderon punën e Mitrush Kutelit si autor tekstesh me një prozë mbresëlënëse, ku përshkruhen edhe këngët më të rëndësishme të trimërisë. Si në një ekran filmi, kalojnë dhe analizohen shkencërisht përmbajtja dhe origjina e Baladës së Rozafës, Kënga e Konstandinit dhe Doruntinës, Kënga e Halil Garrisë, Balada e Gjergj Elez Alisë, që siç shkruan Ullmar, “ka tipare të përbashkëta me legjendën suedeze kushtuar Shën Goranit dhe kulshedrës (Georg – Gjergj – Göran), që është një motiv i përhapur gjerësisht”. Është mbresëlënëse veçanërisht një ndër përfundimet

që arrin autori i librit, kur thotë: “Një gjë, sidoqoftë, është e sigurtë: Këngët, si ato për Konstandinin e Doruntinën dhe për Gjergj Elez Alinë, i kanë mësuar shqiptarët se nuk ka ndonjë gjë që është e pamundur për vullnetin njerëzor. Se asgjë nuk mund ta pengojë mbrojtjen e nderit, sedrës dhe atdheut...”. Duke u ndalur te disa nga rrëfenjzat mbështetur në *Tregime të moçme shqiptare* të Kutelit, suedezi Kvik, iu bën të njohur lexuesve këto rrëfenjëza si një pasuri kulturore dhe shpirtërore, por edhe i nënvizon si për të vulosur aksiomën se “Të huajt erdhën e shkuan, kurse populli shqipatr mbeti ngulur në këtë tokë ilire”.

Trajtimi i problemeve për emancipimin e mëtejshëm të grave dhe të vajzave, pra të gruas në përgjithësi, është bërë nga Ullmar në një këndvështrim modern. Madje, ai me një mendim të mprehtë analizon dhe vë përballë një fjalim të Mit'hat Frashërit dhe një fjalim të Enver Hoxhës, duke arritur në përfundime interesante dhe kuptimplote. Bindemi për mënyrën sesi Ulmar e trajton temën e emancipimit të gruas, për ardhmërinë e fatit të saj, aq më tepër, sepse analizën rreth kësaj teme e bën një qytetar dhe studiues suedez, vendi i të cilit ka parametrat më të lartë të emancipimit të gruas në Evropë dhe në botë.

Në Shqipëri, jo se ka munguar mendimi i përparuar në qëndrimin ndaj gruas dhe lirive të saj, por e kanë përcaktuar qëndrimin ndaj femrës një sërë faktorësh dhe problematikash, të lidhura ngushtë me mentalitetet e trashëguara kanunore, me varfërinë e skajshme, me mungesën e urave komunikuese me mendimin më të përparuar evropian. Kanë ndikuar dukshëm negativisht ndaj femrës, komplekset patriarkale dhe të prapambetura të qeverisjeve të trashëguara, si ato të periudhës së pushtimit osman, ajo e mbretit Zog dhe qeverisja komuniste. Kjo e fundit, bëri disa hapa përpara në emancipimin e femrës shqiptare, duke punuar për arsimimin e saj, por edhe duke e bërë pjesëmarrëse në elektrifikimin e vendit etj., Gjithsesi, ky pushtet, pavarësisht propagandës për emancipim, përsëri nuk arriti t'i jepte femrës, vendin që i takonte.

Femra shqiptare, veçanërisht ajo e fshatrave, e zonave të thella të vendit e rurale, mbeti shpeshherë në pozitat e një skllaveje” të familjes, duke “i ngarkuar kompetencën” e punëve shtëpiake dhe atyre të kuzhinës. Në shembujt që sjell në libër, siç janë rastet

e dy vajzave nga Kosova të shtrënguara të largohen nga dhuna familjare dhe të ndërtojnë familje bashkëkohore, Ullmar, krahas qëndrimit kritik që mban ndaj mentaliteteve dhe karakterit të vrazhdë të disa prindërve, që janë skllëvër të zakoneve kanunore, nuk nguron të tregohet kritik edhe ndaj institucioneve, qofshin edhe suedeze për nevojën e një tolerance dhe angazhimi më të madh në ndihmë të humanizmit dhe dashurisë njerëzore, për ata njerëz në nevojë, e veçanërisht për gratë ose vajzat e pambrojtura. Ai shkruan: “Njollat e këtilla duhet të nxirren në dritë. Duhet të jetë e qartë për çdo njeri në këtë botë që thirret në të drejtat njerëzore, se prindërit nuk mund ta caktojnë jetën e fëmijëve të tyre, se prindërit dhe të tjerët nuk mund të kenë pushtet vendimtar mbi çështje kaq personale, si fejesa dhe martesë. Askush nuk ka të drejtë të vendosë mbi jetën e të rriturve të tjerë, askush nuk ka të drejtë ta detyrojë askënd në një lloj jete, të cilën ai apo ajo e urren. Kjo është një gjë elementare, që do të duhej të ishte e vetëkuptueshme. Dhe ne duhet t’i mbrojmë principet e këtilla demokratike”.

Duke analizuar gjuhën shqipe, etimologjinë, huazimet dhe ngjashmëritë që ajo ka me gjuhët e tjera, Ullmar tregon dashamirësinë dhe respektin e tij për gjuhën shqipe si vazhdim i ilirishtes edhe në rastin kur shprehet se: “Thënë në përgjithësi, nuk është aspak befasishtë po qe se shqipja është përdorur edhe në formën e shkruar përpara shekullit XV”. Është rasti të përmendim këtu, edhe kulturën e gjerë etimologjike të fjalëve që përdoren në këtë libër dhe që janë njëherazi edhe një informacion i pasur për gjuhësinë shqiptare, dialektologjinë e leksikologjinë.

Në librin e tij, Prof. Ullmar, na krijon një njohje më të gjerë për figurën e Erik Hans Tunman (1746-1778), një hulumtues mbi gjenezën e shqiptarëve, i cili ndonëse vdiq në moshë shumë të re (32 vjeç), arriti të botonte një sërë punimesh shkencore që shquhen nga një pjekuri e madhe, një qëndrim i thellë dhe vetëkritik. Më e njohura nga këto punime është *Hulumtime në lidhje me historinë e popujve evrolindorë* (1774), prej të cilave vetëm pjesa e parë është botuar. Në këtë vepër, tema “Mbi historinë dhe gjuhën e shqiptarëve dhe të vllahëve” përfshin faqet 171 - 366”. Tunmani e konsideron problemin me ilirët dhe shqiptarët si një çështje kardinale dhe vjen në përfundimin se ilirët janë stërgjyshërit e

shqiptarëve. Ai thekson se “në historinë e shqiptarëve nuk kam gjetur ndonjë gjurmë nga ndonjë emigrim i kohëve të vona: gjuha e tyre na ka dhënë asofarë dëshmish mbi fatin e popullit, saqë unë nuk mund të mos i pranoj ata si fqinjë të grekëve të vjetër dhe nënshtetas të Romës antike. Dhe në të dyja këto raste ata janë të njëjtë me ilirët”.

Duke shkruar për vlerat e shpirtit dhe të humanizmit shqiptar, Ullmar nuk lë pa përmendur edhe faktin tashmë të njohur dhe të deklaruar nga vetë shtetas të Izraelit se “Shqipëria ishte i vetmi vend ku asnjë hebre nuk ishte tradhtuar, edhe pse mosdorëzimi i hebrenjve ishte me rrezik për shqiptarët”. Ndërkaq, me një penë të hollë dhe shprehje mirësie, suedezi Ullmar Kvik, sjell në faqet e librit lidhjet e hershme të shqiptarëve dhe njohjen për vendin e tij, Suedinë. Kalojnë si sekuenca filmi ngjarje të *Doktor Gjilpërës*, të Faik Konicës, *Astalavista* e Petro Markos, përshkrimet e bukura që bën Sterjo Spasse gjatë vizitës së tij dhe që i përshkruan po aq bukur i biri Iliden Spasse në librin *Im atë, Sterjo!*, kujtimet e ngrohta të Musine Kokalarit dhe përshtypjet e ndjera dhe jetësore të saj për novelat e nobelistes suedeze Selma Lagerlof, ku siç shprehet edhe Ulmar: “Përfytyrimet e mira e të ndritshme na ndihmojnë të mbijetojmë”.

Ndërkohë, është interesante analiza që i bën Ullmar nevojës së zhvillimit të vërtetë demokratik të vendit, ndihmës dhe mbështetjes që duhet t'i japë Evropa Shqipërisë. Sikurse është realiste dhe objektive analiza që ai i bën periudhës së sundimit të Enver Hoxhës në Shqipëri. Ullmar afishon në mënyrë sintetike dëshmitë e personave konkretë, që e kanë vuajtur më shumë atë periudhë, e cila kishte një simbolikë të quajtur “diktatura e proletariatit”, por që në thelb ishte diktaturë e individëve të veshur me pushtet mbi popullin. Periudha që erdhi më pas, ose më saktë, tranzicioni demokratik, nuk është se i zgjidhi tërësisht problemet e shqiptarëve, por ai u dha atyre, atë që është më e shtrenjta për njeriun, lirinë. E megjithatë, politika dhe qeverisjet në Shqipëri, më shumë kanë menduar sesi ta sundojnë dhe jo ta drejtojnë popullin. Nganjëherë, krijohet përshtypja, se ata që marrin pushtetin, edhe sikur njëqind vjet të qëndrojnë në krye të vendit, përsëri do t'ua hedhin fajin vetëm atyre që sapo ikën dhe nuk marrin mundimin të shikohen edhe vetë për pak çaste në pasqyrë, duke analizuar

me përgjegjësi demokratike se çfarë kanë bërë ata vetë në vitet e demokracisë shqiptare.

Është e rëndë ta thuash, por duke parë mënyrën sesi vepron politika shqiptare, herë - herë krijohet iluzioni se ajo e ka shndërruar popullin në një "mushkë" që ndërron vetëm "kalorësit". Disa nga politikanët e rëndësishëm shqiptarë, e kanë të vështirë të shërohen nga sëmundjet e disa prej paraardhësve të tyre të së shkuarës turkoshake, zogiste ose komuniste, duke vuajtur nga delire, duke ngulmuar me çdo kusht, që gjithnjë të jenë ata në krye.

Zogu e shpalli veten mbret të shqiptarëve. Asnjëherë nuk është sqaruar e kuptuar se me çfarë lloj arsyeshe e argumentesh e ndërmori një veprim të tillë. Enver Hoxha, ndonëse propagandonte ide dhe teori revolucionare të masave, e shpalli veten "Njësh", që i kishte të gjitha në dorë, si një perandor i përjetshëm. Kështu, me të tilla reminishenca të së shkuarës po vazhdon kjo histori. Ata që kanë qenë ministra, dëshirojnë me çdo kusht të bëhen kryeministra ose presidentë, doemos, përndryshe formojnë pafundësisht parti të reja, të cilat paguhen duke varfëruar skajshëm popullin shqiptar.

Në librin e Prof. Ullmar, janë me interes për lexuesin dëshmitë e disa njerëzve që kanë vuajtur në burgjet e diktaturës, që hedhin dritë mbi fakte që shqiptarët të cilët "ndërtonin socializmin" mbase i merrnin me mend, por që nuk i dinin se ishin aq makabre. Në këto analiza, libri jep mësimin e madh që populli duhet të hapë sytë dhe të mos mashtrohet, por me mekanizmin e votës, ai të vendosë në krye ata njerëz që emeritojnë, që t'i shërbejnë jo vetes, familjes dhe klaneve mafioze, por t'i shërbejnë popullit me devotshmëri e përkushtim.

Lexuesi i paanshëm dhe realist, pajtohet plotësisht me Prof. Ullmar, kur ai shprehet se regjimi komunist ishte "krevat i Prokustit për popullin shqiptar".

Suedezi Ullmar, i vlerëson ngjarjet dhe situatat që kaloi Shqipëria në këtë tranzicion demokratik, si të ishte njëri nga ne, si të ishte një vëllai ynë më i madh, i cili na vlerëson, por edhe kërkon të na gjendet pranë në çaste të vështira. Duket se Ullmar, e respekton shprehjen e Herodotit se: "Veshëve u duhet besuar më pak se syve, prandaj dhe unë shkruaj ato që kam parë dhe jo ato që kam dëgjuar". Bindemi për këtë, edhe me faktin se Ullmar Kvik, nuk e ka parë botën shqiptare nga larg, përkundrazi, ai ka

qenë shpeshherë në Shqipëri, në trojet shqiptare: në vitet `70, `78, `79, `94, `95, 2004, 2005, 2011. Më se gjysmë shekulli, ai ka pasur kontakte dhe ka bërë vizita të vazhdueshme në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, ose te arbëreshët e Italisë dhe në hapësira të tjera të diasporës.

Jo më kot, ne kemi shprehjen që miku i vërtetë, duket në kohë të vështira, dhe mund ta them me respekt e bindje, se suedezi i dashuruar me ne shqiptarët dhe historinë tonë, mbetet nga ata miq të vërtetë, që e ka dashur dhe e do Shqipërinë, si vëllai - vëllain, ndonëse i përkasim dy kombeve e vendeve të ndryshme, gjeografikisht larg njëri-tjetrit. Kjo nuk i pengon aspak ndjenjat humanitare mes njerëzve që e duan të mirën, paqen dhe përparimin, lirinë dhe demokracinë, por që duan dhe e thonë të vërtetën ashtu siç është, pa zbulime, pa subjektivizma dhe pa patos emocional.

Libra të tillë na duhen dhe na nevojiten, por i nevojiten po aq edhe botës, që të lexojë zëra të paanshëm dhe realistë e objektivë për historinë e një vendi si Shqipëria. Vlerësojmë këtë libër të Ullmar, edhe për mbështetjen në një literaturë të gjerë dhe të pasur, me referenca, por dhe duke nxjerrë konkluzione dhe arritur në përfundime origjinale dhe të sakta.

Shpreh konsideratë të lartë edhe për përkthimin korrekt dhe me kulturë gjuhësore që i bën këtij libri Hajdin Abazi, i cili e shpreh qartë dhe pa ekuivoke fjalën dhe mendimin e autorit të librit, duke i bërë nder vetes si përkthyes, por edhe lexuesve, sepse na paraqet një libër të pastër, të qartë dhe transparent në gjuhën e shkruar, me frazeologjinë e nevojshme, sintaksën e përdorur dhe leksikun e pasur, duke zbatuar këshillën e Floberit, "Të gjesh fjalën e duhur". Ullmar, me veprën e tij, ia ka arritur që ta shpjerë lexuesin në mjedisin kulturor shqiptar, me mprehtësinë dhe aftësinë eksploruese dhe vëzhguese për të depërtuar në thellësi të "ajsbergut" historik shqiptar. Ai, ka arritur të futet plotësisht dhe t'i zhvillojë idetë dhe analizat e tij brenda skenës së historisë shqiptare, me pikëzime dhe nuanca, me ide dhe përfundime shkencore.

## 5.

Natyrisht që ky shkrim nuk është përfundimtar. Nuk do të ishte e drejtë dhe reale, të pretendoj se me një shkrim mund të bëj analizën e plotë të një vepre madhore, si *Më shumë heroizma se sa grurë*. Por, kam bindjen se kjo vepër, do t'i qëndrojë kohës. Tek ajo, duhet të drejtohet më shumë vëmendja e personaliteteve shqiptare të historisë, letërsisë, shkencave social – politike, letrare e gjuhësore. Sikurse, do të ishte në të mirë të studimit të historisë së kombit shqiptar, që ky tekst i plotë, i saktë, i qartë dhe bindës në faktet historike, me konkluzione dhe me referenca serioze, të shërbejë si literaturë origjinale dhe e nevojshme për studentët në Fakultetet e Historisë, Gjeografisë, Gjuhës, Letërsisë...

**Burimet:**

- Revista "Drita", Shefki Oseku.
- Ullmar Qvick(Kvik), *Më shumë heroizma se sa grurë*. Botim i revistës "Dituria", Boras, Suedi. "Grafobeni", Prishtinë 2013.
- Fetah Bahtiri, *Miku i madh i shqiptarëve Ullmar Qvick (Monografi)*. Botues: Shoqata e shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë "Papa Klementi XI Albani", Suedi. Prishtinë 2012.
- Ullmar Qvick (Kvik). "Suedia dhe suedezët në veprat e shkrimtarëve shqiptarë". Kumtesë në seminarin XXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, më 15-27 gusht 2004.
- Ullmar Qvick (Kvik). Ligjëratë e mbajtur në konferencën e tretë për mësuesit e gjuhës amtare shqipe që punojnë në shtetet skandinave, Landskorona më 11 -12 maj 2006.
- Prof. Dr. Murat Gecaj, *Një letër e Viron Konës për Prof. Ullmar Qvick (Kvik)*. Tiranë, 21 korrik 2011.
- Ilire Zajmi, Intervistë me Ullmar Qvick (Kvik). Prishtinë, më 13 shtator 2011, dhënë InfoGLOBI.
- Sokol Demaku, Intervistë dhënë në YLLIPRES dhe revistës "Dituria", Boras, Suedi, më 13.02.2010.
- Suadela Balliu, Nga Suedia me dashuri. Artikull, botuar në gazetën "Mapo". Tiranë, më 13.04.2011.